

Mirjeta Ilazi, PhD¹

UDC: 332.146.2:663/664(497.75)

**TREGUESIT EKONOMIKË PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM
TË INDUSTRISË USHQIMORE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT, RAJONI I POLLOGUT**

**ЕКОНОМСКИ ИНДИКАТОРИ ЗА ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ НА
ПРЕХРАНБЕНАТА ИНДУСТРИЈА ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА, ПОЛОШКИ РЕГИОН**

**ECONOMIC INDICATORS FOR SUSTAINABLE
DEVELOPMENT OF THE FOOD INDUSTRY IN REPUBLIC OF
NORTH MACEDONIA, REGION OF POLOG**

Abstract

Sustainable industrial development depends on a large number of factors that can be grouped for easier analysis. In this paper, we have created a base of research due to economic factors of production, which are synthesized furthermore into indicators and sub-indicators that affect the process of sustainable development. For the formation of the diagram, we started from the information published in books, institutional reports, scientific journals, conversations in the field with representatives of the sectors that affect development, economy and infrastructure were used for analysis. The research was carried out with the AHP (expert choice) methodology. For this reason, the diagram and the structure of the data are created in such a way that we can put more indicators and choose the best one. Sustainable food production means “a method of production using processes and systems that are non-polluting, conserve non-renewable energy and natural resources, are

¹ Doktor i shkencave teknike, Universiteti i Tetovës - UT, RMV. E-mail: mirjeta.ilazi@unite.edu.mk

economically efficient, are safe for workers, communities and consumers, and do not compromise the needs of future generations.

The paper aims to contribute to the implementation of production methods according to the global goals for Sustainable Development (SDG).

The goal is to determine with scientific research the impact of individual indicators on the efficiency of production from the aspect of sustainable development in the agricultural sector and the food industry, where the weighting factors for the indicators that influence the achievement of efficient and sustainable production are further easily determined by mathematical formulas comparable.

Keywords: *sustainable development goals - SDG, sustainable development indicators, Agenda 2030, UN-United Nations Organization, EU-European Union, criterion, sub-criterion, AHP - analytic hierarchy process, MCMD-multiple criteria decisions making, ECH- Expert Choice.*

Hyrje

Zhvillimi i qëndrueshëm shihet si një seri ndryshimesh që duhet të pasojnë për të kombinuar rritje ekonomike nëpërmjet indikatorëve që nuk e cenojnë qëndrueshmërinë mjedisore.

Zhvillimi i qëndrueshëm synon të arrijë rritjen ekonomike duke plotësuar nevojat bazë, pra duke rritur standardin e jetesës. Gjatë zhvillimit të proceseve të prodhimit është parësore të mos ndërpritet zinxhiri zhvillimor dhe të kursehen sa më shumë rezervate të burimeve natyrore për përdorim në të ardhmen. Sigurimi i mirëqenies së ekonomisë dhe përmirësimi i standardit të jetesës bëhet duke rritur të ardhurat dhe duke ofruar vende të reja pune. Për më tepër, rritja ekonomike mund të mbrojë edhe mjedisin duke krijuar parqe, rezerva dhe duke zbatuar politika kryesore. Disa ekonomistë argumentojnë se rritja ekonomike përfundimisht do të çojë në përmirësimin e mjedisit.

Qëllimi i studimit

Prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit është “një metodë prodhimi duke përdorur procese dhe sisteme që nuk ndotin, e ruajnë energjinë e parinovueshme dhe burimet natyrore, janë ekonomikisht efikase, janë

të sigurta për punëtorët, komunitetet dhe konsumatorët dhe nuk rrezikojnë nevojat e brezave të ardhshëm”.

Qëllimi i studimit është sigurimi i mirëqenies dhe zhvillimi ekonomik, përmirësimi i standardit të jetesës, duke i rritur të ardhurat dhe duke ofruar vende të reja pune. Nëpërmjet këtij studimi janë hulumtuar indikatorët që janë të rëndësishëm dhe me ndikim në procesin e prodhimit. Element hulumtimi janë faktorët të cilët e orientojnë qeverisjen në nivel qendror edhe në nivel lokal si dhe drejtpërdrejt në kompanitë prodhuese me qëllim që të rritet efikasiteti i punës pikërisht nga shfrytëzimi i mbetjeve dhe kursimi i energjisë.

Metodat e hulumtimit

Në këtë punim është përdorur si mjet shkencor modeli i njohur me emrin Proces i Hierarkisë Analitike (Analytic Hierarchy Process-AHP), i zhvilluar nga Thomas Saati, i cili është një model që ndihmon vendimmarrësit të arrijnë të gjejnë zgjedhjen më logjike në raste kur vendimet janë më të komplikuar dhe numri i mundësive është i madh.

Metodologjia e hulumtimit përmes AHP paraqet një qasje sistematike për analizën e problemeve komplekse. Këta hapa mund të aplikohen në fusha të ndryshme, siç janë marrja e vendimeve, menaxhimi i projekteve ose vlerësimi i rreziqeve. Hapat kryesor të zhvillimit të procesit hulumtues janë:

1. Definimi i problemit: Ky proces ndihmon në identifikimin e komponentëve bazë të problemit, duke mundësuar një kuptim dhe analizë më të mirë.

2. Organizimi në hierarki: Strukturimi i pjesëve në një formë hierarkike, i cili e lehtëson prioritizimin dhe vizualizimin e marrëdhënieve midis kriterëve dhe alternativave.

3. Caktimi i vlerave numerike: Ky është një hap kyç për matjen sasiore të rëndësisë së secilit kriter, që ndihmon në objektivizimin e vendimeve.

4. Sintetizimi i vlerësimeve: Kjo fazë është e rëndësishme për identifikimin e prioriteteve dhe marrjen e vendimeve përfundimtare bazuar në të dhënat e analizuarat.(1)

Gjatë përdorimit të AHP, ne fillimisht i përcaktojmë opsionet në dispozicion të vendimmarrësve dhe objektivat e tyre vendimmarrëse. Këto synime dhe opsione do të përdoren më pas për të ndërtuar një hierarki analitike, e cila pasqyron faktorët e ndryshëm në procesin e

vendimmarrjes dhe rëndësinë e tyre. Rezultati i AHP është marrja e një vektori prioritar, i cili na jep njohuri për opsionin më të mirë të vendimit për politikëbërësit e rëndësishëm institucionalë.

$$A = [a_{ij}] = \begin{bmatrix} \frac{w_1}{w_1} & \frac{w_2}{w_1} & \dots & \frac{w_n}{w_1} \\ \frac{w_1}{w_2} & \frac{w_2}{w_2} & \dots & \frac{w_n}{w_2} \\ \dots & \dots & \dots & \dots \\ \frac{w_1}{w_n} & \frac{w_2}{w_n} & \dots & \frac{w_n}{w_n} \end{bmatrix}$$

$$w > 0 \quad \sum_{i=1}^n w_i = 1$$

Procesi i Hierarkisë Analitike (AHP) është një metodë vendimmarrjeje me shumë kritere e bazuar në teorinë e përparësisë.(2)

Vendimmarrja me shumë kritere (Multi-Criteria Decision Making – MCDM) mund të përkufizohet si një proces i vlerësimit të situatave nga bota reale, bazuar në kritere cilësore-sasiore në një mjedis rreziku të caktuar dhe të pasigurt, qëllimi përfundimtar i të cilit është të propozojë drejtimet më të mira për të vepruar.(3) (4) Procesi i ndërtimit të hierarkisë zhvillohet në disa faza, siç janë:

- Aktivitetet paraprake për informim,
- Zgjedhje e elementeve që do t'i përfshijmë në hulumtim,
- Strategjia dhe
- Politika ndërmjet opsioneve të disponueshme.

Problemi është edhe më i vështirë për t'u zgjidhur nëse përfshihen më shumë kritere dhe një numër më i madh vendimmarrësish (5). Vlerësimi i situatave të tilla me shumë kritere duke përdorur qasjet konvencionale të disponueshme mund të jetë një proces jashtëzakonisht i vështirë. Prandaj, është e nevojshme një qasje e strukturuar me shumë kritere të vendimmarrjes (Structured Decision Making - SDM), në mënyrë që të vizualizohet dhe të gjendet vlera sasiore e procesit të vendimmarrjes. (6) (7) (8)

Metodologjia është e aftë që të zhvillojë:

- zbrërthimin e strukturës komplekse të problemit në pjesë përbërëse;
- organizimin e pjesëve në një strukturë hierarkike (kriteret, nënkriteret, alternativat, etj.);
- caktimi i vlerave numerike nga 1 deri në 9 sipas rëndësisë relative të secilit kriter;
- sintetizimi i notave për të përcaktuar prioritetet kryesore.

Saaty sugjeron që numri i niveleve në hierarki të kufizohet në gjashtë, me një maksimum prej 9 pozicioneve në çdo nivel. Ky konstatim bazohet në mendimin e psikologëve se njerëzit mund të marrin parasysh 7 ± 2 parametra në të njëjtën kohë.

Tabela 1. Shkalla numerike për vlerësim sipas Saatit

Shkalla numerike	Përkufizimi
1	Dy elementë janë po aq të rëndësishëm
3	Një element është pak më i rëndësishëm se tjetri
5	Një element është shumë më i rëndësishëm në krahasim me një tjetër
7	Një element është shumë më i rëndësishëm se tjetri
9	Dominimi absolut i një elementi mbi një tjetër
2, 4, 6, dhe 8	Vlerat mesatare midis dy niveleve ngjitur
(1/x)	Vlera e atribuar kur aktiviteti i krahasohet me aktivitetin j bëhet reciproke kur j krahasohet me i

Për shkak të faktit se kjo qasje është mjaft fleksibile për të trajtuar kriteret cilësore dhe sasiore, ajo është aplikuar gjerësisht në një numër aplikimesh të vlerësimit të performancës dhe politikëbërjes. Në këtë hulumtim, kjo metodë është përdorur për të zbuluar treguesit më të rëndësishëm dhe për t'i zbatuar ato në aktivitetet e përditshme ekonomike, të cilët do të kontribuojnë për të arritur në efikasitet më të madh.

Procesi i aplikimit të metodës AHP ka katër faza:			
Strukturimi i problemit	Mbledhja e të dhënave	Vlerësimi i peshës relative	Përcaktimi i zgjidhjeve të problemeve

Faza e strukturimit të problemit fillon që kur lindi ideja për të realizuar një hulumtim, qëllimi kryesor i të cilit është të nxisim rritje të efikasitetit ekonomik duke u bazuar te faktorët Global për Zhvillim të Qëndrueshëm, që njihen si SDG (sustainable development goals).



Foto1. Faktorët për Zhvillim të Qëndrueshëm

Agjenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 është një dokument kyç për përparimin global drejt qëndrueshmërisë. Me 17 qëllimet e saj për zhvillim të qëndrueshëm (SDGs), kjo agjendë ofron një kornizë për arritjen e paqes, prosperitetit dhe mbrojtjes së planetit. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) konstaton se përfundimi i varfërisë dhe formave të tjera të mjerimit duhet të shoqërohet me strategji që përmirësojnë shëndetin dhe arsimimin, reduktojnë pabarazitë dhe nxisin rritjen ekonomike.

Korniza e faktorëve ekonomik, së bashku me nënfaktorët e përfshirë në këtë hulumtim, paraqitet në tabelën nr. 2

Tabela 2. Faktorët dhe nënfaktorët që hulumtohen në këtë punim

Rritja ekonomike
<ul style="list-style-type: none"> • Energji më e lirë • Burimet lokale • Rritja e eksportit • Reduktimi i importeve • Mundësi pune
Papunësia
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e pagave • Rritja e sigurimit • Ulja e çmimeve të ushqimeve
Ulja e varfërisë
<ul style="list-style-type: none"> • Produkte organike • Paketim i ricikluar
Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë ushqimore
<ul style="list-style-type: none"> • Investime adekuate • Aktivitetet të vazhdueshme • Zbatuesit
Sistemi financiar i qëndrueshëm
<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e taksave • Subvencionet • Kushtet e kreditimit

Pjesëmarrës në hulumtim janë të anketuarit, të cilët zgjidhen sipas kompetencave të ndarë në grupe varësisht nga lloji i indikatorëve të cilët hulumtohen, respektivisht preferencat, ku u shprehën më shumë se 40 ekspertë nga fusha të ndryshme (komuniteti akademik, ministrinë, autoritetet lokale, kompanitë dhe konsulentët e pavarur).

Tabela 3. Shembull si vendosen indikatorët në çifte për tu vlerësuar gjatë intervistimit

	Rritja ekonomike	Papunësia	Shmangia e evazionit	Ulja e nivelit të varfërisë	Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë së prodhimit të ushqimit
Rritja ekonomike					
Papunësia					
Shmangia e evazionit					
Ulja e nivelit të varfërisë					
Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë së prodhimit të ushqimit					

Qasja indirekte në përcaktimin e peshës së faktorit përmes krahasimit të çiftëve, si paraqitet në tabelën 3, dhe përcaktimit të preferencave është një nga avantazhet e qarta të AHP-së, si dhe mundësia për identifikimin e pjesëmarrësve jo seriozë përmes kontrollit të inkonsistencës. Nga ana tjetër, në rast se ka një numër të madh çiftesh për krahasim, për të cilët pjesëmarrësit duhet të shprehen, është shumë e rëndësishme që ata të jenë vërtet të motivuar dhe të përqendruar. Prandaj, duke marrë parasysh këtë kompleksitet, rekomandohet të përdoren workshop-e të ndryshme për plotësimin e pyetësorëve ose intervista të drejtpërdrejta.

Në vazhdim do të shtjellohen faktorët të cilët janë vendosur si pjesë e hierarkisë dhe janë hulumtuar me ndihmën e softverit Expert choice (ECH), i cili paraqet një mjet që mbështet procesin e vendimmarrjes multikriteriale të bazuar në Metodën Analitike Hierarkike (AHP). Konkretisht, metoda AHP është implementuar në softuerin EC, i cili përpunon të dhëna për vendimmarrje individuale dhe grupore. Kjo lejon strukturimin efikas të vendimeve komplekse, analizimin e kritereve dhe vlerësimin e opsioneve në kontekste të ndryshme.

Rritja ekonomike

Zhvillimi i qëndrueshëm synon të nxit rritjen ekonomike duke plotësuar nevojat bazë, pra duke rritur standardin e jetesës. Ne gjithashtu duhet të mbajmë rezerva të burimeve natyrore për përdorim në të ardhmen. Sigurimi i mirëqenies së ekonomisë dhe përmirësimi i standardit të jetesës, duke rritur të ardhurat/ofrimin e vendeve të punës. Për më tepër, rritja ekonomike mund të mbrojë edhe mjedisin duke krijuar parqe, rezerva dhe duke zbatuar politika kryesore. Rrjedhimisht, disa ekonomistë argumentojnë se rritja ekonomike do të çojë përfundimisht në përmirësimin e mjedisit.

Punësimi

Norma e punësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut u rrit në 48.10 për qind në tremujorin e parë të 2020 nga 47.90 për qind në tremujorin e katërt të 2019.

Në Maqedoninë e Veriut, shkalla e punësimit mat numrin e njerëzve që kanë një punë nga përqindja e popullsisë në moshë pune.

Të papunët përfshijnë të gjithë personat e aftë për punë, të cilët:

- Kanë qenë të papunë gjatë periudhës së referencës, pra nuk kanë qenë në punë me pagesë ose të vetëpunësuar;

- Aktualisht janë në dispozicion për punë, d.m.th. janë të disponueshëm për punësim me pagesë ose vetëpunësim në periudhën referuese; dhe

- Kërkojnë punë, d.m.th. ndërmarrin hapa konkretë në një periudhë të caktuar të fundit për të kërkuar punë me pagesë ose vetëpunësim.

Shkalla e papunësisë në Maqedoni është ulur në 16.2 për qind në tremujorin e parë të vitit 2020 nga 17.8 për qind në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ishte shkalla më e ulët e papunësisë që nga fillimi i serisë në vitin 2004, pasi numri i të papunëve ra me 14.7% në 156.627 dhe numri i të punësuarve u rrit me 21.7% në 811.106. Ndërkohë, shkalla e aktivitetit u rrit në 57.4 për qind nga 57.1 për qind në tremujorin e parë të vitit 2019, si dhe shkalla e punësimit u rrit në 48.1 për qind nga 46.9 për qind në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në tremujorin e fundit të vitit 2019, shkalla e papunësisë ishte më e lartë, 16.6%. (10)

Në shumë kontekste kombëtare mund të ketë persona që nuk janë aktualisht në tregun e punës, që dëshirojnë të punojnë, por nuk

‘kërkojnë’ punë në mënyrë aktive, sepse i shohin mundësitë e punës si të kufizuara, ose sepse kanë lëvizshmëri të kufizuar të punës, ose përballen me diskriminim strukturor e të tjera, barriera sociale ose kulturore. Kategoria e njerëzve që duan të punojnë, por nuk kërkojnë punë, shpesh quhen “papunësi e fshehur” ose “të papunë të qetë”, ku përfshihen edhe persona të njohur si “punëtorë të dekurajuar”. Këtu ndikon edhe numri i grave, të cilat për shkak të barrierave të ndryshme nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive. Një faktor tjetër që çon në përjashtimin nga numri i të papunëve i referohet kriterit që punëtorët janë të disponueshëm për punë në një periudhë të caktuar për arsye se kryejnë punë sezonale.

Ulja e varfërisë

Duke marrë parasysh statistikën në RMV të cilat kanë orientim drejt standardeve ndërkombëtare dhe nevojën për të ofruar të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht, përkufizimi i Eurostat-it përdoret si përkufizim bazë i varfërisë.

➤ Personat, familjet dhe grupet e personave, burimet e të cilëve (materiale, kulturore dhe sociale) janë në një nivel të tillë që i përjashton nga mënyra minimale e pranueshme e jetesës në vendin ku jetojnë, konsiderohen si të varfër (9).

Në 17 Objektivat Globale për Zhvillim të Qëndrueshëm, qëllimi #1 ka të bëjë me krijimin e një bote pa varfëri.

Sipas OKB-së, varfëria nënkupton pamundësinë për të gjetur zgjidhje si shkelle të drejtave dhe dinjitetit bazë të njeriut. Do të thotë mungesë kapaciteti për pjesëmarrje efektive në shoqëri. Është pamundësia për të ofruar kujdes shëndetësor për familjen, mungesa e ushqimit dhe veshmbathjes së mjaftueshme për fëmijët, mospasja e një pune për të fituar para ose e tokës së mjaftueshme për të siguruar ushqimin dhe pamundësia për të marrë kredi. Varfëria do të thotë pafuqi, pasiguri dhe përjashtim të individit, familjes dhe komunitetit. Ajo nënkupton ndjeshmëri ndaj dhunës dhe shpesh nënkuptohet edhe si detyrim për të jetuar në mjedise të brishta ose marginale, pa ujë të pastër dhe kanalizime.

Agjenda 21 thekson se varfëria është një nga problemet më komplekse dhe shumëdimensionale, me origjinë si në domenin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Qeveria e RMV në vitin 2010 kishte miratuar “Strategjinë kombëtare për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social” në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010-2020. Strategjia

Kombëtare tregonte aspektet dhe ndikimet e ndryshme të fenomeneve që shprehin varfërinë dhe përjashtimin social. Në këtë dokument janë sintetizuar tregues të shumtë të dukurive shoqërore dhe janë analizuar, krahasuar dhe paraqitur më gjerësisht. (10)

Qëllimi kryesor strategjik për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social në Republikën e Maqedonisë së Veriut është:

➤ Zvogëlimi i varfërisë dhe i përjashtimit social në RMV do të arrihet përmes shfrytëzimit të mirë dhe forcimit të burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion, përmirësimit të kushteve të jetesës, punës dhe gjendjes sociale të të gjithë qytetarëve.

Është e nevojshme që bashkëpunimi sistematik dhe institucional të funksionojë për të arritur zhvillim më të shpejtë, standard më të lartë, cilësi më të mirë të jetës dhe zhvillimin e mekanizmave për përfshirjen sociale të kategorive të cenueshme të qytetarëve në kontekstin lokal.

Si lidhen qëndrueshmëria dhe varfëria?

Varfëria shpesh bën që njerëzit të ushtrojnë presion relativisht më të madh mbi mjedisin, kapitalin natyror të varfëruar, cenueshmërinë klimatike, pabarazinë gjinore, migrimin rural-urban dhe rritjen e kërkesave për burime, përdorimin e energjisë ndotëse etj. (11)

Zhvillimi i qëndrueshëm i prodhimit të ushqimit

Prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit është “një metodë prodhimi duke përdorur procese dhe sisteme që nuk ndotin mjedisin, ruajnë energjinë e parinovueshme dhe burimet natyrore, janë ekonomikisht efikase, janë të sigurta për punëtorët, komunitetet dhe konsumatorët dhe nuk rrezikojnë nevojat e brezave të ardhshëm”.

Praktikat e qëndrueshme bujqësore kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, zgjerimin e bazës së burimeve natyrore të Tokës dhe ruajtjen dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës.

Objektivi #12 nga SDG (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm) i referohet prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm.

Konsumi dhe prodhimi botëror, që është forca lëvizëse e ekonomisë globale, bazohet ende në përdorimin e mjedisit natyror dhe burimeve në një mënyrë që vazhdon të ketë ndikime shkatërruese në planet.

Prodhimi dhe konsumi i qëndrueshëm do të thotë të krijosh më shumë dhe më mirë me më pak burime dhe më pak dëme. Kjo

nënkupton që rritja ekonomike duhet të ndahet nga degradimi i mjedisit dhe forcimi i rritjes së efikasitetit të burimeve duke promovuar një mënyrë jetese të qëndrueshme.

Sistemi financiar i qëndrueshëm

Përmbledhjet e fundit të të dhënave tregojnë se shumë njerëz të varfër dhe jo të varfër në shumë vende në zhvillim përballen me nivele të larta përjashtimi financiar dhe barriera të larta për qasjen në financa. Prandaj, përfshirja financiare luan një rol kyç në reduktimin e varfërisë. Arritja e një shpërndarjeje të barabartë është një faktor i rëndësishëm që do të kontribuojë në rritjen e nivelit të mirëqenies dhe gjithëpërfshirjes (12) (13).

Shmangia e evazionit fiskal

Ne nuk mund t'i përmbushim Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) pa vendosje gjithëpërfshirëse të taksave. Për të kapërcyer hendekun financiar të SDG, vendet në zhvillim do të duhet të taksojnë më shumë dhe më mirë. Komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë vazhdimisht ka rritur përpjekjet e veta për ta mbështetur adaptimin e sistemit fiskal, me qëllim që të arrihet qëndrueshmëri më e madhe nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike në kolektiv për përfshirje në fiskalizim dhe ekonomi lojale.

Shumë vende në zhvillim, së bashku me ato që bëjnë fushatë për zhvillim të qëndrueshëm, besojnë se shmangia e taksave nga kompanitë shumëkombëshe është një kontribues kryesor në rrjedhat negative të çekuilibrave në burimet financiare. Por këtë qëndrim nuk e ndajnë vendet e origjinës së këtyre kompanive shumëkombëshe. (12)

Epoka e parajsave fiskale duhet të përfundojë më në fund. Kështu, parajsat fiskale nxisin krizën e pabarazisë që i lë vendet e varfra pa burimet që u nevojiten.

Dua të theksoj se është shumë e rëndësishme të arrihet një përqindje më e lartë e përfshirjes në grupin e taksapaguesve sesa të rriten taksat vetëm për paguesit lojal, ndërsa grupi i atyre që veprojnë ekonomikisht dhe nuk janë të përfshirë si taksapagues të vazhdojnë punën pa qenë të evidentuar në regjistrin e subjekteve juridike dhe pa paguar taksat. Është më e rëndësishme që të gjithë të kujdesen njësoj për pronën publike dhe që kujdesi për të mirat publike në vendin tonë të rritet.

Gjetjet dhe rezultatet

Faktorët i kemi vendosur në një hierarki për të marrë mendimin e ekspertëve sipas kriterëve të metodologjisë së zgjedhjes së ekspertëve (ECH) në fusha të caktuara, të cilët janë gjithashtu kompetent për të bërë ndryshime dhe ndërhyrje në fushat ku operojnë. Në tabelën nr. 2 janë paraqitur kriteret dhe nënkriteret që janë tregues për zhvillim të qëndrueshëm ndaj të cilëve mund të bëhen ndryshime dhe përshtatje për të arritur qëllimin kryesor të hulumtimit “Përcaktimi i treguesve për zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë ushqimore”(12)(11)(10).



Figura 2. vlerat e peshës së faktorëve të analizuar me ECH

Duke përdorur sistemin operativ EC, llogaritet pesha e vlerës së faktorëve që janë pjesëmarrës në hulumtim, domethënë kryhet një përmbledhje (agregim) e peshës së faktorëve të të gjithë pjesëmarrësve, të cilët korrespondojnë me elementët e matricës.




Figura 3. Rezultatet, vlerat numerike të faktorëve ekonomik dhe alternativave

Në figurën 2. është paraqitur pesha e faktorëve me vlera numerike, pra renditja e faktorëve ekonomik që janë përfshirë në hulumtim sipas metodologjisë Procesi i Hierarkisë Analitike. Sipas përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit, alternativat që kanë të bëjnë me faktorin ekonomik tregojnë qartë se lartë është vlerësuar faktori “Investimet në arsim” si nënkriter kyç, dhe menjëherë pas tij qëndron faktori “Teknologjitë e reja” si zgjidhje që do të bëjë ndryshimin në proceset e prodhimit dhe në sistemin arsimor. Në fakt, është i lidhur ngushtë zhvillimi ekonomik me proceset më të fundit të zhvillimit dhe ndikimin e Industrisë 4.0. Nevoja për zgjidhje të reja inovative që janë produkt i arsimit dhe kërkimit të mirë dhe cilësor është padyshim rruga drejt së cilës duhet të zhvillohemi si rajon dhe si vend për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. Nevoja për arsim cilësor me investime në pajisje dhe laboratorë, me edukim profesional në përputhje me politikat e zhvillimit industrial është garanci për zhvillimin industrial, por edhe në objektet e mëtejshme kërkimore dhe institucioneve shkencore në të cilat do të zhvillohen teknologji të reja për përmirësimin e proceseve të prodhimit.

Hulumtimi me këtë metodë na jep informacion edhe për rangimin e Alternativave si pikë plotësuese e hulumtimit.

Alternativa 1	Infrastruktura dhe inovacioni	113	3
Alternativa 2	Investimet e huaja	021	5
Alternativa 3	Energjia e rinovueshme	047	4
Alternativa 4	Teknologjitë e reja	200	2
Alternativa 5	Investime në arsim	619	1

Figura 4. Rangu i vlerësimit të alternativave

Siç mund të shihet në figurën me nr. 4, alternativa më e vlerësuar është alternativa 5, “Investime në arsim”, me 619 njësi nga 1000 gjithsej sa i ka algoritmi, që e konfirmon edhe një herë se zhvillimi ekonomik varet drejtpërdrejt nga zhvillimi në të gjitha nivelet e arsimit ku duhet të bazohen njohuritë për përdorim të teknologjive efikase.




Figura 5. Peshë e vlerës së faktorëve prioritar edhe shkalla e konsistencës

Në figurën nr 5. e kemi paraqitur vlerësimin numerik të të tre shtyllave të hulumtimit, faktorët ekonomik, social dhe faktorët e grupit ekologjik, ku e kemi edhe treguesin e shkallës së jokonzistencës të marrë direkt nga vegla elektronike hulumtuese, e cila është 0,35% dhe na jep të kuptojmë se kemi përgjigje që kanë kronologji dhe janë konzistente.

Conclusion

From the conducted analysis, the contribution of each group of indicators and their relative importance can be observed. The results of this research provide us with much information and reveal that sustainable development seems more costly and difficult in the short term, but when aiming for the visionary development of the country, we conclude that changes are necessary immediately, because we are already witnessing the global food shortage, especially organic food, and pollution-free production. Parts of state policies form the entirety of development. All parts must function in a system where each contributes to achieving the goal. Therefore, in the research, we have interpreted three groups of factors that can hardly act separately at any given moment. The fact that the values and rankings of the factors change during the analysis shows that expert opinions undergo changes depending on the elements included in the research.

An economic system should be developed based on a circular economy that aims to eliminate waste and continuously use resources. In a world with limited resources, producers in their products must make adjustments and implement sustainable and efficient production methods that benefit consumers and save the planet. To increase

production efficiency and extend the life cycle of production, all the indicators studied have an impact. As seen from the results obtained through mathematical methods, enabled by the AHP tool (Analytic Hierarchy Process) and the ECH software (Expert Choice), the most emphasized priority is the factor “Investment in education”, which would create conditions for the inclusion of new technologies and the increase of efficiency in a chain-like manner.

During the collection of information from the experts involved in the research, it was observed that the constant factor in increasing efficiency is the people themselves and the way they think. Objectives need to be coherent, without creating conflicts between the parties depending on which perspective they speak from and what they aim to achieve. Investment in education is both a factor and an alternative for development, thus presenting the urgent need for a turning point that will take us out of the spiral. Education of specialized and well-prepared personnel will enable the functioning and operation of each organizational unit, starting from the family all the way to the state system. Personnel trained according to the “Sustainable Development Goals” will enable the use of more efficient new technologies that use renewable alternative energy, which does not pose a threat to nature and humanity. A “circular economy” focuses on products and materials that last longer in the production process. In a circular economy, products are reused.

Recensentë:

Prof. dr. Atanas Kočov

Prof. dr. Sulbije Mehmeti

Referencat:

1. Nguyen, Giang Huong. *Mathematical Model for Decision Making Problems*. s.l.: <http://www.wooster.edu/>, 2014.
2. D. Mladenovska, A.M. Lazarevska.: *Decision making concept for creating policies for natural gas supply chain in Macedonia*; s.l.: SDEWES Dubrovnik, 2015.
3. R.L, Keeney. *Decision analysis: state of the field. Technical report 82-2, Woodward – Clyde Consultants*, . San Francisco: s.n., 1982.

4. J.W, Raiffa H. Pratt. *Decisions with Multiple Objectives, Preferences and Value Tradeoffs*, Wiley. New York: s.n., 1976.
5. K. Srinivasa Raju, D. Nagesh Kumar. *Multicriterion analysis in Engineering and Management; PHI Learning*. New Delhi: s.n., 2010.
6. Pomerol, J. Ch. and S. B. Romero. *Multicriterion Decision in Management: Principles and Practice; Kluwer Academic Publishers*. Netherlands: s.n., 2000.
7. Koontz, Wehrich H. &. *Management: aglobal perspective 10th Edition*. s.l.: New Delhi: Tata McGraw-Hill Publishing Company Limited, 2001.
8. M.K, Robbin S.P & Coulter. *Psychology cognitive (5th Ed.) McGraw-Hill Inc.*, 2002.
9. <https://www.stat.gov.mk/Default.aspx>. *Сиромаштија* .
10. <https://mtsp.gov.mk/>. *Национална стратегија за намалување на сиромаштијата и социјалната исклученост*.
11. [https://www.google.com/search?q=sustainabilityand+no+poverty.Sustainable Development Goal 1](https://www.google.com/search?q=sustainabilityand+no+poverty.Sustainable+Development+Goal+1). s.l.: <https://www.unep.org/explore-topics/sustainable-development-goals/why-do-sustainable-development-goals-matter/goal-1-no>.
12. Ismail O. Fasanya, Taiwo Adewale Muritala. *SciPress Ltd*.
13. Македонија, Влада На Република Северна. *Фискална Стратегија На Република Северна Македонија За 2022-2024*. Скопје, мај 2021.